

**A - Lutjes për lëshimin e lejes së parë unike për shkak të zbatimit të shërbimeve jashtë kufirit me punëtorët e dërguar duhet bashkëlidhur:**

- fotografinë e të huajit ose numrin referues nga deponimi elektronik i fotografive;
- pasaportën ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës së të huajit;
- dëshminë mbi sigurimin social nga shteti, nga i cili është dërguar, i cili përfshinë edhe sigurimin shëndetësor, i cili mbulon së paku shërbimet shëndetësore emergjente në Republikën e Sllovenisë. Në qoftë se sigurimi social nga shteti amë nuk përfshinë sigurimin shëndetësor, bashkëlidhet dëshmia mbi sigurimin shëndetësor adekuat, i cili mbulon së paku shërbimet shëndetësore emergjente në Republikën e Sllovenisë.
- dëshminë për mjete të mjaftueshme për mbijetesë;
- vërtetimin nga evidenca penale të shtetit amë të huajit;
- kontratën për zbatimin e shërbimeve për porositësin;
- dëshminë mbi regjistrimin e punëdhënësit të huaj.

**Në procedurën e lëshimit të lejes unike njësia administrative sipas detyrës zyrtare do ti siguroi të dhënat në vijim:**

- nga evidenca penale, evidenca e aktgjyqimeve të plotfuqishme përkatësisht aktvendimeve për kundërvajtjet, të cilat në Republikën e Sllovenisë i mbanë Ministria e drejtësisë;
- nga evidencat për vendimet e plotfuqishme të kundërvajtjeve, të cilat i mbajnë organet për kundërvajtje në Republikën e Sllovenisë;
- mbi aktakuzat e plotfuqishme të depozituara dhe aktgjyqimet e jo plotfuqishme të lëshuara, të cilat i mbanë gjykata kompetente;
- nga evidencat, të cilat i mban organi tatimor mbi detyrimet tatimore të jopaguara të skaduara dhe mbi kundërvajtjet tatimore, të cilat janë të shënuara si sekret tatimor.

**B – Lutjes për lëshimin ose vazhdimin e lejes unike për shkak të aftësisë në shoqërinë ekonomike në Republikën e Sllovenisë duhet bashkëlidhur:**

- fotografinë e të huajit ose numrin referues nga deponimi elektronik i fotografive;
- pasaportën ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës së të huajit;
- dëshminë mbi sigurimin social nga shteti, nga i cili është dërguar;
- dëshminë për mjete të mjaftueshme për mbijetesë;
- vërtetimin nga evidenca penale të shtetit amë të huajit gjithmonë në rastin e lutjes për lëshimin e lejes së parë, kurse në rastet tjera, nëse organi kështu kërkon;
- kontratën mbi aftësimin, të kontraktuar midis shoqërisë ekonomike me seli në Republikën e Sllovenisë dhe shoqërisë ekonomike me seli në shtetin tjetër anëtar të UE ose KEE;
- dëshminë mbi regjistrimin e punëdhënësit të huaj;
- kontratën mbi punësimin me punëdhënësin, me seli në shtetin tjetër anëtar të UE ose KEE, të përkthyer në gjuhën sllovene.

**Në procedurën e lëshimit të lejes unike njësia administrative sipas detyrës zyrtare do ti siguroi të dhënat si në vijim:**

- nga evidenca penale, evidenca e aktgjytimeve të plotfuqishme përkatësisht aktvendimeve për kundërvajtjet, të cilat në Republikën e Sllovenisë i mbanë Ministria e drejtësisë;
- nga evidencat për vendimet e plotfuqishme të kundërvajtjeve, të cilat i mbajnë organet për kundërvajtje në Republikën e Sllovenisë;
- mbi aktakuzat e plotfuqishme të depozituara dhe aktgjykimet e jo plotfuqishme të lëshuara, të cilat i mbanë gjykata kompetente;
- nga evidencat, të cilat i mban organi tatimor mbi detyrimet tatimore të jopaguara të skaduara dhe mbi kundërvajtjet tatimore, të cilat janë të shënuara si sekret tatimor.

**Informata lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale:**

- të dhënat personale nga formulari për qëllim të lëshimit të lejes për qëndrim përpunohen në ujdi me nenin 93. të Ligjit për të huajt;
- organi ka të drejtë që të përfitoi edhe të dhëna tjera, nëse kjo është në interesin tuaj dhe se për këtë e keni dhënë pëlqimin ose nëse kjo është e lejuar me ligj, pëlqimin mund ta revokoni kurdoherë pranë organit;
- nëse për këtë janë plotësuar kushtet e parashkruara, keni të drejtë ndaj informimit me të dhënat tuaja personale, të drejtën ndaj përkufizimit të përpunimit dhe të drejtën ndaj kundërshtimit të përpunimit;
- keni të drejtë që të verifikoni saktësinë e të dhënave tuaja personale, të shënuara në lejen për qëndrim, dhe të drejtën që të kërkonti ndryshimin e tyre ose, nëse për këtë janë të plotësuar kushtet e parashkruara, fshirjen e tyre;
- menaxhuesi i ruan të dhënat tuaja në ujdi me nenin 115. të Ligjit për të huajt;
- kontakti i personit të autorizuar të menaxhuesit për mbrojtjen e të dhënave personale në Ministrinë e punëve të brendshme: posta elektronike: [dpo.mnz@gov.si](mailto:dpo.mnz@gov.si);
- nëse jeni të mendimit, se të dhënat tuaja po përpunohen joligjshëm, mund të ushtroni ankesë pranë Autorizuesit të informimit.